REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës:	2019:096165
Datë:	03.03.2020
Numri i dokumentit:	00870155

P.nr. 419/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJE-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin e vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit, A I, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1, nën par. 1.4 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në P, PP/II.nr. 353/19, të dt. 24.04.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të dt. 11.11.2019, 12.12.2019 dhe të dt. 13.02.2020, në prezencë të Prokurorit të shtetit Muharrem Bajrakatri, të pandehurit A I, mbrojtësit i tij av. Isa Osdautaj sipas autorizimit, dhe e dëmtuara F G, me dt 13.02.2020 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.03.03.2020, përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

I pandehuri

A I, i biri i O dhe nënës H, e gjinisë SH, i lindur me dt. .., në D, me vendbanim në P, rr. "..", nr..., identifikohet në bazë të lnj.nr. personal .., ka të kryer shkollën fillore, me profesion – punëtor i sigurimit në Spitalin Regjional në P, i martuar, baba i 3 fëmijëve, gjendjes së dobët ekonomike, posedues i nr. tel ..., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

- Me dt. 05.02.2019, rreth orës 09:39 minuta, Spitali Rajonal-Reparti i Kirurgjisë në P, me dashje i shkakton lëndime te lehta trupore te dëmtuarës F G nga fshati LL i B-I, ne atë mënyrë qe pasi e njëjta ne vendin e cekur me lartë kishte shkuar për te marrë dokumentacionin mjekësor për rregullimin e pensionit, i pandehuri e kap për krahu dhe e godet ne fytyrë me grusht, ku me pas disa punëtorë i ndihmojnë qe te ngritët dhe e njëjta lajmëron policinë.

- Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 nenpar 1.4 të KPRK-së,

2019:096166

Andaj, gjykata konform nenit 7, 41, 42, 43, 46, 73, 74, 75 par.1, nën par. 1.3, neni 188 par.1 nenpar 1.4 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurin e:

GJ Y K O N

- **Dënim me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) euro**, e të cilin dënim do te paguaj pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi ne afatin kohor brenda 3 (tre) muajve.

- Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

- I pandehuri obligohet në pagimin e paushallit gjyqësor shumen prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- E dëmtuara F G nga fshati ,,,-I, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në P-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.353/19, të dt. 24.04.2019, ndaj të pandehurit A I, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 nenpar 1.4 të KPRK-së,

Me dt 11.11.2019, 12.12.2019 dhe13.02.2020, është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor në prezenc të Prokurori të Shteti Muharrem Bajraktari , të pandehurit A I, mbrojtësi të av. Isa Osdautaj sipas autorizimit dhe të dëmtuarës, F G,

Gjykata konform dispozitave te nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaron se e ka kuptuar këto të drejta dhe ka shtuar se për mbrojtës e ka shfrytëzuar këtë të drejtë.

Në shqyrtimin gjyqësor të dt. 13.02.2020 , mbrojtësi i të pandehuri ka deklaruar se pas konsultimeve me të mbrojturin e tij , kërkon nga gjykata qe të mbrojturiu të tij ti ipet mundesija qe edhe njëherë te deklarohet lidhur me pranimin e fajësie.

Gjykata konformë nenit 248 par 5 të KPP-së, i ka dhënë mundësin qe i pandehuri te deklarohet lidhur me fajësinë.

I pandehuri deklaroj se pas konsultimeve me mbrojtësin e tij dhe me vullnet të plotë e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndihet i penduar, premton se ne te ardhmen nuk do te përsëris vepra te tilla penale, por do te jetë i përmbajtur, i kërkon falje palës së dëmtuar.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurori i Shtetit, ku prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë që bëri këtu i pandehuri, ku me sa ka kuptuar është pranim i vullnetshëm, pas konsultimit me mbrojtësin e tij, i vetëdijshëm për pasojat dhe

2019:096166

përparësitë e pranimit të fajësisë, e po ashtu ky pranim ka mbështetje në shkresat e lëndës, sipas KPP-së i pandehuri gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor mund të deklarohet për fajësinë, kështu që sot i pandehuri e shfrytëzoi këtë mundësi, e këtë duke u bazuar në ligj.

E dëmtuara ka deklaruar se do të paraqet kërkesë pasurore juridike ndërsa lidhur me pranimin e fajësisë pajtohet me fjalët e prokurorit te shtetit.

Mbrojtësi i të pandehurit av. Isa Osdautaj ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturi të tij.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 326 lidhur me nenin 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve dhe me shqiptimin e dënimit.

Prokurori Muharrem Bajraktari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga vet pranimi i fajësisë që bëri i pandehuri u vërtetua se i njëjti e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, në dëm të dëmtuarës F G. Kërkon nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor ta dënojë sipas ligjit e po ashtu si rrethanë lehtësuese ta ketë parasysh pranimin e fajësisë dhe faktin se këtë vepër e ka kryer në orarin e tij të punës dhe në vendin e punës.

E dëmtuara në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk ka çka të shtojë vetëm i përkrah fjalët e prokurorit të shtetit, ndërsa për kërkesë pasurore juridike është deklaruar më herët.

Mbrojtësi i të pandehurit, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i mbrojturi i tij e pranoi fajësinë, gjykatës i propozon që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese të të njëjtit ti merr parasysh për faktin se i njëjti është mbajtës i familjes, ka qenë në marrëdhënie pune po aty ku ka ndodh rasti, i premton gjykatës se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin. Nga këto të cekura gjykatës i propozon që të njëjtit ti shqipton një masë sa më të butë, lidhur me veprën për të cilën pandehet.

I pandehuri A I, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk ka çka të shton e përkrah në tërësi fjalën e mbrojtësin e tij, ndërsa palës së dëmtuar i kërkon falje.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë, pasi qe i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, dhe pranimi i fajit mbështetet edhe në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me nr. të rastit 2019-DA-0237 i datës 05.02.2019, raporti i oficerit i datës 05.02.2019, deklarata e të dëmtuarës F G e datës 05.01.2019, deklarata e të pandehurit e datës 05.02.2019, deklarata e dëshmitarit I S e datës 06.02.2019, ekspertiza mjekoligjore e datës 01.04.2019, si dhe shkresat tjera te lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së , ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit A I qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale se ka kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nenpar. 1.4 te KPRK-së.

2019:096166

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, gjykata mori sjelljen korrekte në gjykatë, gjatë shqyrtimit gjyqësor, pranimin e fajësisë, sinqeritetin deklarues, pendimin për veprën e kryer, si dhe faktin se me parë nuk ka qenë i dënuar dhe nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nënpar 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale, për paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, te pandehurit i obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË P-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.419/19, dt. 03.03.2020

Bashkëpunëtore profesionale **GJ Y Q T A R I**

_____ _____
Selvane Bukleta Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar
ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita
e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë,
e nëpërmjet të kësaj gjykate.

2019:096166